

deri në 90 ditë nga dita e hyrjes, përbrenda periudhës gjashtë muajshe (180 ditë). Periudha fillon nga momenti kur për herë të parë hyni në këtë territor në periudhën gjashtë muajshe. Për shembull, nëse hyni në zonën Shengen për herë të parë më 15 shkurt, periudha e ardhshme gjashtë muajshe fillon më 15 gusht. Nëse udhëtoni shpesh në zonën Shengen, është përgjegjësia juaj që të numëroni se sa ditë ju kanë mbetur në periudhën gjashtë muajshe.

Në këtë mënyrë, mund të realizoni më tepër udhëtime të shkurta, me kusht që kohëzgjatja e tyre e përgjithshme nuk kalon kohëzgjatjen prej 90 ditësh në periudhën 6 muajshe.

A mund të jetoj dhe punoj në zonën Shengen sipas rregullores së re?

Rregullorja e re vlen vetëm për udhëtim dhe nuk u jep qytetarëve të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë të drejtën e qëndrimit mbi 3 muaj apo të drejtën e punës në vendet që përfshihen në zonën Shengen.

Nëse planifikoni qëndrim më të gjatë se tre muaj, nëse dëshironi të punoni ose të kryeni studime që tejkalojnë kohëzgjatjen 90 ditëshe, ju lutemi shënoni se para nisjes duhet të bëni kërkesë për vizë afatgjate, leje qëndrimi ose leje pune në Ambasadën ose Konsullatin e vendit në të cilin do të udhëtoni.

Të punosh dhe të jetosh në zonën Shengen pa leje pune ose leje relevante qëndrimi është jolegale.

A ekzistojnë kërkesa të tjera për hyrje në shtetet në fjalë?

Personat që kanë pasaporta biometrike nuk ka nevojë të plotësojnë kërkesa shtesë financiare apo administrative, për të udhëtuar lirisht në vendet e Shengenit. Megjithatë, kushtet e zakonshme hyrëse zbatohen për të gjithë qytetarët e vendeve në zhvillim, të cilët udhëtojnë në zonën e Shengenit.



Prandaj, ekziston mundësia që shërbimet kufitare të kërkojnë nga udhëtarët të demonstrojnë mjetet e udhëtimit dhe ato të ekzistencës për periudhën e qëndrimit në zonën Shengen. Nga udhëtarët mund të kërkohej gjithashtu të saktësojë vendin e qëndrimit (për shembull, të tregojnë rezervimin e hotelit ose adresën në të cilën do të qëndrojnë).

Përveç kësaj, udhëtarët nuk duhet të konsiderohen si persona që i kërcënohen rendit publik, shëndetit publik apo sigurisë së brendshme. Nuk duhet të jenë as persona për të cilët është dhënë alarmi i refuzimit të hyrjes në këtë zonë. Autoritetet kufitare të Shteteve Anëtare mbajnë të drejtën e refuzimit të hyrjes nëse nuk plotësohen këto kërkesa dhe japin vendimin përfundimtar për hyrje (Neni 5 i Konventës së Shengenit).

Procedura speciale do të zbatohet në kufi me Greqinë. Autoritetet greke nuk do të vënë vula hyrëse apo dalëse në pasaportat e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Autoritetet greke do të vulosin një fletë të ndarë, e cila do t'i jepet personit që udhëton.

Rekomandime për udhëtarët

- Udhëtoni me agjenci të besueshme udhëtimi
- Kontrolloni a ju duhet sigurim shëndetësor dhe sipas cilave kushte (dokument/formular konfirmimi nga zyra përkatëse e shëndetësisë). Sigurimi shëndetësor është i preferueshëm.
- Nëse udhëtoni në zonën Shengen me automobil, atëherë duhet të posedoni leje ndërkombëtare vozitjeje dhe sigurim ndërkombëtar të automobilit (kartoni i gjelbër).
- Nëse udhëtoni me aranzhim privat, kontrolloni adresën, qytetin dhe emrin e hotelit në vendet e Shengenit, duke përdorur internetin.

Numri i urgjencës në Europë është 112 dhe vlen për të gjitha shtetet e UE-së (për policinë, ambulancën ose për zjarrfikësit).

*Për informata të tjera, vizito ueb faqen tonë:
<http://www.delmkd.ec.europa.eu/>
ose kontakto Ambasadën ose Konsullatin e shtetit në të cilin udhëtoni.*

Delegacioni i Unionit Europian
Mito Haxhivasiliev Jasmin 52v. 1000 Shkup
Tel: (+389 2) 3248 500 / Fax: (+389 2) 3248 501
E-mail: Delegation-FYRMacedonia@ec.europa.eu



Udhëtimi i liruar nga vizat për qytetarët e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë



Udhëtimi pa viza arriti edhe për qytetarët e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë

Duke filluar nga 19 dhjetori 2009, qytetarët e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë nuk do të ketë nevojë të posedojnë vizë për të udhëtuar në 25 shtetet anëtare të UE-së dhe në tre shtete të tjera që nuk janë anëtare të UE-së por janë pjesë e zonës së Shengenit. Qytetarët që kanë pasaportë biometrike, tani mund të udhëtojnë lirisht në këto vende, dhe në periudhë gjashtë muajshe të qëndrojnë në vizita afatshkurta prej 90 ditësh – qoftë për punë, studime ose për qëllime turistike.

Në cilat vende tani mund të udhëtoni pa vizë?

Rregullat e reja aplikohen në të gjitha shtetet anëtare të UE-së, si dhe në Islandë, Norvegji dhe Zvicër, përveç në Britaninë e Madhe dhe Irlandë.

Lista e shteteve:

<i>Austri,</i>	<i>Finlandë,</i>	<i>Letoni,</i>	<i>Portugali,</i>
<i>Belgjikë,</i>	<i>Francë,</i>	<i>Lituani,</i>	<i>Rumani,</i>
<i>Bullgari,</i>	<i>Gjermani,</i>	<i>Luksemburg,</i>	<i>Slovaki,</i>
<i>Qipro,</i>	<i>Greqi,</i>	<i>Maltë,</i>	<i>Sloveni,</i>
<i>Republikë Çeke,</i>	<i>Hungari,</i>	<i>Hollandë,</i>	<i>Spanjë,</i>
<i>Danimarkë,</i>	<i>Islandë,</i>	<i>Norvegji,</i>	<i>Suedi,</i>
<i>Estoni,</i>	<i>Itali,</i>	<i>Poloni,</i>	<i>Zvicër.</i>

Pse përjashtohen Britania e Madhe dhe Irlanda?

Britania e Madhe dhe Irlanda mbeten jashtë zonës së Shengenit dhe prandaj rregullat e reja nuk vlejnë për këto dy shtete. Për informata mbi kërkesat e hyrjes në këto dy vende, qytetarët e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, mund të drejtohen në përfaqësitë konsulare britanike dhe irlandeze.

Si ta kuptoj a është pasaporta ime biometrike apo jo?

Pasaportat biometrike në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë kanë filluar të jepen që nga prilli i vitit 2007. Kontrolloni nëse në ballinën e pasaportës qëndron ky simbol.



Nëse simboli qëndron në ballinë, atëherë pasaporta juaj është biometrike dhe mund të udhëtoni me të pa vizë në shtetet e lartpërmendura.

Si mund të pajsem me pasaportë biometrike nëse deri tani nuk posedoj një të tillë?

Nëse akoma nuk keni pasaportë biometrike, duhet atë ta kërkonit nga autoritetet që japin pasaporta, që të mund të udhëtoni pa vizë në vendet në fjalë.



A mund të udhëtoj akoma me pasaportën time të vjetër që nuk është biometrike?

Pasi që pasaportat jo-biometrike nuk janë të parapara për udhëtime të lira nga vizat, do të mund të udhëtoni vetëm nëse keni vizë valide për zonën e Shengenit. Për më tepër informata, ju lutemi kontaktoni autoritetet e vendit tuaj ose përfaqësitë konsulare të shteteve të Shengenit.

Sipas rregullave të reja, sa kohë mund të qëndrojnë udhëtarët në zonën e Shengenit?

Në pajtim me rregulloren e re, qytetarët e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, të cilët posedojnë pasaporta biometrike, mund të qëndrojnë në zonën e Shengenit (të gjitha shtetet anëtare të UE-së dhe shtetet që asocohen me zonën Shengen: Zvicra, Norvegjia dhe Islanda, përveç Britanisë së Madhe dhe Irlandës)

